

NJOFTIM

MBI PROVIMIN E AVOKATISE 13 NËNTOR 2020

Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë njofton se provimi i avokatisë së radhës, bazuar në kërkesave të nenit 21 pika 2 e ligjit nr. 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, do të zhvillohet ditën e **Premte, datë 13 Nëntor, ora 14.30**. Provimi do të zhvillohet në ambientet e godinës “Iliria” tek qyteti studenti.

Të gjithë personat e interesuar dhe që plotësojnë kriteret sipas nenit 13/2 të ligjit të mësipërm, duhet të regjistrohen për pjesëmarrjen në provim. Regjistrimet fillojnë në datën 13 Tetor 2020 dhe përfundojnë në datën 11 Nëntor 2020.

Asnjë person nuk mund të marrë pjesë në provim, pa u regjistruar më parë pranë Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, me seli Rruga “Murat Toptani”, Qendra e Biznesit “Eurocol”, kati 9, Tiranë.

Të gjithë kandidatët që kanë ndjekur kursin e plotë të trajnimit fillestar pranë Shkollës së Avokatisë dhe që janë regjistruar me vërtetim nga ana e fakultetit përkatës për shkak të mospajisjes me kartonin e diplomës, duhet të kenë me vete edhe fotokopje të çertifikatës së Shkollës së Avokatisë dhe fotokopje të noterizuar të diplomës MASTER profesional ose shkencor. Kandidatët që nuk kanë shlyer detyrimet financiare të frekuencimit të Shkollës së Avokatisë duhet të shlyejnë detyrimet e më pas të regjistrohen për pjesëmarrje në provim.

Për sqarime më të hollësishme mund të paraqiteni pranë ambienteve të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë ose të kërkoni informacion në nr. e telefonit 04 2 251876.

KOMITETI DREJTUES I DHASH